



REPUBLIKA E SHQIPERISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME LEZHË SH.A
ZYRA JURIDIKE
PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Materiale Hidraulike”

Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-51026-06-12-2025

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Materiale
hidraulike
44115210-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 080 239 (dymilion e tetedhjetemije e dyqind e tridhjetë e nente) lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Autoriteti/enti Kontraktor “Shoqëria Rajonale e Ujësjiellës-Kanalizime Fier” Sh.A, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

➤ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022,2023,2024) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 20 %** e vlerës së përllogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 20%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet është në përpjesëtim dhe e lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, bazuar kjo në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. neni 43, pika 6.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM –së Nr.992, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumentave të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të **balanceve për vitet (2023-2024)** të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar(të vitit 2025) sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"i ndryshuar; (lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2024), në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin. (Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" te ndryshuar, ku përcaktohet: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) gjendjen ekonomike dhe financiare; ...3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Në nenin 43 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare" të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" te ndryshuar VKM Nr.498 date 1.8.2024, paragrafi 1 dhe 2 germa "b", parashikohet: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare¹. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji; Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Pika 3.12 e tij, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25 date 10.05.2018 "Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 9 ku parashikohet: "Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përrjashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat"; Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor

Adresa :Lagjia "Nene Tereza", Rruga Bajram Curri, Ndertese 2-Kateshe ne zonen kadastrale nr.8632, numri i pasurise 1/130, Lezhë.

dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Ne keto kushte, vleresojme të kërkojme kete dokumentacion pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe akt ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Njësia e prokurimit kerkoi edhe pagesat e taksave vendore bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”(te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga çdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit se në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të rregjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

U përcaktuan kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qenë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet/mallrat e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar në sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose / dhe faturave tatimorë të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar në sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 OE ofertues duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose distributori zyrtar për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori i autorizuar, operatori ekonomik duhet të provojë me dokument, lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme pika 2.3.4 është vendosur sipas nenit 40 pika 3, neni 44 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe në nenin 36 pika 3/b) të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Ky kriter është vendosur ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një Deklaratë që merr përsipër transportin dhe lëvrimin e mallrave drejt ambjenteve magazinuese të Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor në formulimin e kriterit për kapacitetin transportues të mallrave, i qëndron rigorozisht faktit se OE i cili do të shpallet fitues, duhet të kryejë edhe transportin në destinacion të mallrave objekt prokurimi, për nevojat e AK, i cili nuk do të paguaj shpenzime shtesë për këtë shërbim.

2.3.4 Operatorët Ekonomik në momentin e dorezimit të dokumentacionit, duhet të paraqesin nga një mostër për artikujt/zërat/mallra objekt prokurimi.

Argumentimi: Bazuar në nenin 40 pika 6/gërma(a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; Udhëzimin nr.3 datë 12.04.2022 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomik”. Ky kriter vendoset me qëllim që Autoriteti Kontraktor të verifikojë nëse mallrat e ofertuara i plotësojnë specifikimet teknike në DST dhe janë brenda standarteve të kërkuara.

2.3.5 Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentin e titulluar **Ofertë Teknike** i paraqitur nga AK në formën e një tabele (*pjese e dokumentacionit të specifikimeve teknike*), kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë listën e artikujve që kërkohen. Dokumenti Oferte Teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr.i produktit	Emërtimi i produktit	Emri i kompanisë prodhuese	Emri i katalogut	KODI i produktit ose nr.i Faqes në katalog ose dok. e noterizuar	Shënim sqarues

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 40 pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Qëllimi i vendosjes të kriterit të sipërcituar ka të bëjë me faktin e orientimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në fazën e ofertimit të dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatorët pjesëmarrës.

SPECIFIKIME TEKNIKE

➤ **TUBOT HDPE**

Tuba polietileni me dendësi të lartë. Tubat të kenë një koeficient sigurimi minimalisht 1.20. Materialet e përdorurapërprodhimin e tubavetëjane jo toksike dhe të mos ndikojnë në cilësinë e ujit (most’I japin atij as erë as shije). Të jenë fleksibël dhe me rezistencë ndaj vibrimeve dhe goditjeve sizmike, për t’u përshtatur me relievin e tokës.Të jenë rezistent ndaj rrezeve ultraviolett dhe ndaj temperaturave -25 deri në 55°C.Të kenë rezistencë të lartë ndaj gërryerjes dhe jetegjatesi te pakten 50 vjet.Pamja e jashtme: të kenë siperfaqe të lëmuar dhe pa dëmtime, prerja fundore e tubit duhet të jetë e pastër dhe në kënd të drejtë me qendrën e tubit.Produktet duhet të kenë certifikate aprovimi nga të paktën 1(një) institucion ndërkombëtar ose kombëtar për përdorimin për ujë të pijshëm (p.sh DVGW).

➤ **Manikote EF HDPE100 PN 16-25**

Manikotat EF HDPE100 PN 16-25 duhet të ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin. Ato duhet të jenë të prodhuara me plastike HDPE 100 te paster dhe jo plastike te riclikuar, për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm. Tensioni i punes të jetë minimumi 47V. Manikotat EF HDPE100 PN 16-25 duhet të jenë të pajisura me një tregues për 16-25 ngjitjen, këto tregues duhet të jenë të vendosura afër me konektorët dhe të jenë te sigurta qe te mos kete rrjedhje te materialit ngjites. Produktet duhet te jene te markuara ne trup me marken CE ose ekuivalent.

Toleranca ne diameter dhe trashesi per keto produkte te mos jete me shume se $\pm 5\%$. Produktet duhet të kenë certifikate aprovimi nga të paktën 1(një) institucion ndërkombëtar për përdorimin për ujë të pijshëm (p.sh WRAS etj). Permasate manikotave EF HDPE100 PN16-25 te jenë të përshtatshme për tu salduar nga një makineri saldimi.

➤ **Saracineska Ø 250 Pn 16, SARACINESKA Ø 300 Pn 16, Saracineska Ø 400 Pn 16, Ajruet gize Ø 80, Ajruet gize Ø 150, Ajruet gize Ø 50, Reduktor presioni**

Saracineska Ø 250 Pn 16, SARACINESKA Ø 300 Pn 16, Saracineska Ø 400 Pn 16, Ajruet gize Ø 80, Ajruet gize Ø 150, Ajruet gize Ø 50 dhe Reduktor I presionit duhet te jete gize dhe e lyster me boje epokside me nje trashesi prej minimum 250µm.

Temperatura e punes se ketyre saracineskave te jete nga 0 deri ne 60°C (do te pranohen temperatura pune dhe me te larta). Veshja epokside duhet te jete vendosur ne saracineska me pjekje ose me shkrirje. Bulonat, dadot dhe ronelet e saracineskave te jene prej celiku te veshur me zinc.

Për të gjithë standartet e sipërpërmendura, do të pranohen dhe ekuivalentet e tyre të huaja dhe shqiptare.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj". Sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

SASIA E MALLIT QË KËRKOHET:

Argumentimi:

Sipas nevojave te Autoritetit Kontraktor

Afatet e lëvrimit: 10 dite nga nenshkrimi i kontrates

Destinacioni: Magazina e Shoqërisë Rajonale Ujesjelles Kanalizime Lezhe sh.a

Nr.	Lloji i Mallit	Njesia	Sasia
1	Tub PE ϕ 25	ml	500
2	Tub PE ϕ 32	ml	400
3	Tub PE ϕ 40	ml	250
4	Tub PE ϕ 50	ml	400
5	Tub PE ϕ 63	ml	250
6	Tub PE ϕ 75	ml	150
7	Tub PE ϕ 90	ml	200
8	Tub PE ϕ 110	ml	150
9	Tub PE ϕ 125	ml	100
10	Tub PE ϕ 160	ml	80
11	Tub PE ϕ 180	ml	40
12	Tub PE ϕ 200	ml	50
13	Tub PE ϕ 250	ml	45
14	Tub PE ϕ 315	ml	40
15	Manikotë EF ϕ 160	copë	14
16	Manikotë EF ϕ 90	copë	60

Adresa :Lagjia "Nene Tereza", Rruga Bajram Curri, Ndertese 2-Kateshe ne zonen kadastrale nr.8632,
numri i pasurise 1/130, Lezhë.

17	Manikotë EF ϕ 200	copë	10
18	Manikotë EF ϕ 250	cope	12
19	Manikotë EF ϕ 315	cope	8
20	Bashkues me kompension ϕ 25	cope	100
21	Bashkues me kompension ϕ 32	cope	80
22	Bashkues me kompension ϕ 40	cope	80
23	Bashkues me kompension ϕ 50	cope	60
24	Bashkues me kompension ϕ 63	cope	60
25	Bashkues me kompension ϕ 75	cope	30
26	Bashkues me kompension ϕ 90	cope	40
27	Bashkues me kompension ϕ 110	cope	20
28	Ajrues gize ϕ 80	copë	5
29	Ajrues gize ϕ 150	copë	3
30	Saraçineskë ϕ 250 Pn 16	copë	3
31	Saraçineskë ϕ 300 Pn 16	copë	2
32	Saraçineskë ϕ 400 Pn 16	copë	2
33	Ajrues gize ϕ 50	cope	6
34	Reduktor presioni ϕ 200	cope	1